



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 1, DATË 11 / 02 /2026

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “VLORË
TEDA/RAMS FREE ZONE” ME SUBJEKT APLIKUES RAMS ALBANIA SHPK
NUIS M42427018I**

Në mbështetje të nenit 8, 9, 17, 18, 22, 24, 26, 27, 28 dhe 31 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi”;
- Procedura e vlerësimit të projektit bazohet në nenin 17 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2015 “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e Fondit të Pasurive të

Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS)”;

- Vlera e investimit të projektit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 100,000,000 (njëqind milion) Dollarë;
- Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe numri i personave të punësuar parashikohet të jetë 10,000 (dhjetë mijë) persona;
- Projekti i investimit propozohet të realizohet nga subjekti aplikues Rams Albania sh.p.k. me NUIS M42427018I.
- Projekti i propozuar për zhvillim ndodhet brenda një territori të përcaktuar si Zonë të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 04.06.2008, “Për shpalljen ‘Zonë Ekonomike’, Vlorë dhe VKM nr. Nr.628, datë 11.6.2009 “Për shpalljen “zonë ekonomike”, me statusin e “zonës së lirë”, të një territori në Vlorë, ndryshuar me VKM nr.928, datë 25.11.2020.
- Projekti i investimit shtrihet në një sipërfaqe totale prej afro 158,2 ha në ZK 2765 dhe 8604, Bashkia Vlorë, nga të cilat 86,5 ha janë në pronësi të pretenduara “shtet”, 65,4 ha në pronësi “privat” dhe 6,3 ha janë pasuri pa informacion kadastral.
- Nga verifikimi hartografik dhe konfirmimet zyrtare të ASHK-së rezulton se zona e kërkuar i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik në bazë të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, por kërkon përditësim dhe saktësim të hartave kadastrale për pasuritë që ndodhen brenda gjurmës së saj, nevojitet ndërmarrja e procedurave përkatëse administrative nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për përditësimin e të dhënave kadastrale, saktësimin e kufijve dhe reflektimin e situatës reale në terren, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Projekti i investimit propozohet të zhvillohet si një ekosistem industrial logjistik dhe inovativ, i cili do të përfshijë ndër të tjera teknologjinë industriale, automatizim dhe inteligjencë artificiale. Përpunim mekanik të lehtë të metaleve duke kombinuar metalurgjinë e pastër me aktivitete të kufizuara në përpunim mekanik të lehtë dhe trajtime sipërfaqësore jo-ndotëse dhe energjinë e rinovueshme.
- Subjekti aplikues do të veprojë në cilësinë e zhvilluesit të zonës, duke realizuar përmirësimin

dhe sistemimin e tokës, si dhe ndërtimin dhe garantimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e saj. Në vijim, ai do të mundësojë dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave përkatëse tek përdoruesit, me qëllim ushtrimin e veprimtarive ekonomike brenda zonës, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në ligjin për zonat teknologjike dhe ekonomike.

- Projekti është në përputhje me parashikimet e legjislacionit të investimeve strategjike, pasi sektori strategjik i Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e parqeve industriale/teknologjike e të inovacionit, si dhe pajisjen me infrastrukturën e nevojshme për prodhim, zhvillim industrial, tregtimin dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me veprimtaritë që ushtrohen brenda tyre.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e Veçantë” për projektin e investimit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone” propozuar nga subjekti “Rams Albania” shpk NUIS M42427018I, dhe miratimit në parim të gjurmës sipas Aneks 1 të këtij vendimi.
2. Projekti parashikon realizimin e një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja, të informacionit, hapjen e vëndeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Vlorës duke futur industri që përmbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë në përputhje me kriteret mjedisore të zonës, brenda një sipërfaqeje prej 158,2 ha.
3. Statusi “Investim/Investitor strategjik, Procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”, për një periudhë 4 (katër) vjeçare, status ky i kushtëzuar me realizimin e detyrave sipas planit të veprimit të parashikuar në këtë vendim.
4. Projekti i investimit do të zhvillohet si një zonë e vetme e integruar, ku e gjithë sipërfaqja shpallet Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA), në përputhje me Ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave të Teknologjisë dhe

Zhvillimit Ekonomik”, i ndryshuar. Subjekti ka të drejtën të zhvillojë zonën në lote, duke përfshirë përgatitjen dhe sistemimin e truallit, ndërtimin e infrastrukturës bazë dhe krijimin e kushteve të nevojshme për vendosjen dhe funksionimin e aktiviteteve ekonomike.

5. Duke qenë se zona e synuar për zhvillim ndodhet brenda një territori të përcaktuar si Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me Vendim të Këshillit të Ministrave, nevojitet ndërmarrja e procedurave ligjore për rishikimin dhe/ose shfuqizimin e tyre, me qëllim mundësimin e zhvillimit të projektit sipas konceptit të ri të propozuar. Në këtë kuadër, organet kompetente do të duhet të procedojnë me miratimin e akteve të reja nënligjore dhe administrative, duke reflektuar ndryshimet në statusin e zonës dhe duke garantuar vijimësinë ligjore të procesit të zhvillimit.
6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 22, 24, 26, 27 dhe neni 28 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i miratohen projektit janë si më poshtë vijon:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara, sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
 - c) Miratohet, në parim masa mbështetëse konsolidim toke, si dhe vënie në dispozicion e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik me destinacion zhvillimin e projektit TEDA.

Ministria përgjegjëse për ekonominë, realizon verifikimet e nevojshme me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim konsolidimin e kësaj prone shtetërore për sa i përket saktësisht të sipërfaqeve, statusit të tyre juridik dhe ndarjes së pasurive dhe për aq kohë sa nuk ekzistojnë mosmarrëveshje administrative dhe/ose gjyqësore me shtetin në pasurinë objekt të investimit strategjik.

Kalimi në FPPMIS i pronës shtetërore në zonën kadastrale nr. 2765 dhe nr. 8604, bashkia Vlorë kërkon ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të nevojshme në fuqi nga ana e Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë, pas përfundimit të procesit të konsolidimit

të tokës nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në zbatim të Ligjit Nr.9789, datë 19.7.2007, “Për Krijimin dhe Funksonimin e Zonave Ekonomike” i ndryshuar, neni 4 dhe nenit 14/2, të VKM-së nr. 646, datë 22.07.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, i ndryshuar miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme, si dhe mënyra dhe afatet e vënies në dispozicion të kësaj pasurie të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike.

- d) Pas përfundimit të procesit të konsolidimit dhe qartësimit të situatës juridike kadastrale, si dhe duke konsideruar që brenda gjurmës së projektit, nga verifikimet paraprake rezultojnë të ketë tituj pronësie të palëve të treta private, në bazë dhe zbatim të VKM Nr. 1032, datë 16.12.2015, subjekti duhet të vërë në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private të cilat preken nga investimi potencial.
 - e) Miratohet e drejta për akses në infrastrukturë mbështetëse në bazë të legjislacioneve sektoriale.
7. Ministria përgjegjëse për ekonominë, në zbatim të Ligjit Nr.9789, datë 19.7.2007, “Për Krijimin dhe Funksonimin e Zonave Ekonomike” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, propozon në Këshillin e Ministrave shpalljen e Zonës (TEDA) dhe Zhvilluesit të saj subjektin Rams Albania shpk NUIS M42427018I.
8. Në bazë dhe zbatim të VKM Nr. 1032, datë 16.12.2015 “Për dokumentimin e Marrëveshjeve të Investitorëve Strategjikë me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private”, subjekti duhet të vendosë në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga investimi potencial.
9. Për ato parcela që subjekti nuk faton ende marrëdhënien me pronën sipas VKM-së së sipërcituar, të zbatohen parashikimet e pikës 1 dhe 3 të nenit 28 të ligjit 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kreut II të VKM 1032,

datë 16.12.2015. Kostot financiare të nevojshme për realizimin e këtyre procedurave mbulohen tërësisht nga subjekti kërkues, pas marrjes së autorizimit nga Komiteti i Investimeve Strategjike.

10. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
11. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”, konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
12. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë përditësimin dhe saktësimin e të dhënave kadastrale, përfshirë verifikimin e kufijve, identifikimin e plotë të pasurive të prekura nga projekti i investimit, si dhe pasqyrimin e çdo ndryshimi përkatës në regjistrin kadastral, brenda 2 (dy) muajve nga njohja me këtë vendim.
13. Ngarkohet Ministria përgjegjëse për ekonominë për të propozuar në Këshillin e Ministrave projektvendimin për përfshirjen në fondin e pasurive të paluajtshme për investimet strategjike, brenda 3 muajve nga njohja me këtë vendim.
14. Ngarkohet Ministria përgjegjëse për ekonominë për të propozuar në Këshillin e Ministrave projektvendimin për shpalljen e zonës TEDA dhe Zhvilluesit të saj subjektin “Rams Albania” shpk, brenda 2 (dy) muajsh nga njohja me këtë vendim.
15. Ngarkohet Ministria përgjegjëse për ekonominë për të propozuar në Këshillin e Ministrave projektvendimin për miratimin e kontratës për ndërtimin, administrimin dhe monitorimin e funksionimin e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, brenda 4 muajve nga njohja e këtij vendimi.
16. Ngarkohet subjekti aplikues në zbatim të VKM Nr. 1032, datë 16.12.2015, për të vënë në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga investimi potencial.
17. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit nga ana e autoriteteve publike të masave të përfshira në Planin e Veprimit, të miratuar me këtë vendim.

18. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.

19. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I MJEDISIT

SOFJAN JAUPAJ

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)

PLANI I VEPRIMIT
PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “VLORË TEDA/RAMS FREE
ZONE”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”, përcakton

masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”, është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitorët:

Investitori Rams Albania shpk NUIS M42427018I kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto

Konsolidim prone	Po	ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të kryejë përditësimin dhe saktësimin e të dhënave kadastrale që përfshin verifikimin e kufijve, identifikimin e plotë të pasurive të prekura nga projekti i investimit, si dhe pasqyrimin e çdo ndryshimi përkatës në regjistrin kadastral		2 muaj	
Kalimi i pronës në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike (FPPMIS)	Po	MEI ASHK	Ky veprim bazohet në Nenin 27 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, dhe VKM-në Nr. 1030, datë 16.12.2015.		3 muaj	
Shpallja e zonës TEDA dhe zhvilluesit të saj;	Po	MEI	Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon në Këshillin e Ministrave vendimin për shpalljen e zonës TEDA; shpalljen e subjektit “Rams Albania” shpk zhvillues të projektit “Vlorë TEDA/RAMS Free Zone”, për të vijuar më pas me lidhjen e kontratës		2 muaj	
Vënia në dispozicion e pasurive shtetërore/Lidhja e Kontratës me autoritetin shtetëror.	Po	MEI	Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon VKM për vendosjen e pasurisë shtetërore në dispozicion të subjektit investues me qëllim zhvillimin e projektit për të vijuar më pas me lidhje kontrate me subjektin.		4 muaj	

Vënia në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga investimi potencial.	Po	Subjekti	“Rams Albania” shpk		Në zbatim të VKM nr. 1032, datë 16.12.2015, subjekti aplikues duhet të vendosë në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga investimi potencial.	
Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afatave të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;	Po	AIDA	Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim		Sipas legjislacionit të investimeve strategjike.	
Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;	Po	Institucionet kompetente AIDA	Sipas legjislacionit sektorial Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim			
Mbështetje e investimit për të siguruar lidhjen me rrjetin ekzistues elektrik.	Po me kusht		Të zbatohet legjislacioni në fuqi për mundësinë e lidhjes me infrastrukturën dytësore duke përfshirë lidhjen me pikat ekzistente të energjisë “Ligjin Nr. 43/2015 “Për			

			<p>sektorin e energjisë elektrike”.</p> <p>Për sa i përket kostove për lidhjen me rrjetin ekzistues, ato mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.</p>			
<p>Mbështetje e investimit me infrastrukturë ndihmëse ; Furnizimi me ujë të pijshëm dhe infrastrukturën e kanalizimeve të ujrave të ndotura/KUZ</p>	Po me kusht		<p>Në zonën pranë Pyllit të Sodës është duke u zbatuar projekti i ri i ujësjellësit financuar nga Banka Gjermane.</p> <p>Gjithashtu ekziston rrjet furnizimi me ujë në pjesën jugore dhe veriore të zonës.</p> <p>Në lidhje me infrastrukturën e kanalizimeve të ujrave të ndotura (KUZ), rrjeti ekzistues ndodhet në pjesën lindore të zonës.</p> <p>Kostot e plota për lidhjen me ujësjellësin ekzistues të mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.</p>			
<p>Mbështetje e investimit në infrastrukturë/logjistikë: rrugë shërbime, port/hekurudhë, qasje në rrjet</p>	Po me kusht	<p>Aksesi në infrastrukturë të mundësohet nga subjekti.</p>	<p>Zona ka qasje direkt në rrethrotullimin në hyrjen veriore të Vlorës nëpërmjet rrugëve dytësore ekzistuese. Si korridor lidhës shërben aksin kombëtar Fier-Vlorë. Ky aks lidh portin e Vlorës me rrethrotullimin në hyrjen veriore të Vlorës, nënkalimi në Novoselë ku degëzon rruga e re e Aeroportit të Vlorës.</p> <p>Pika më e afërt e projektit me vijën hekurudhore është në distancë prej 140 m dhe një lidhje me rrjetin kombëtar hekurudhor është e mundshme të sigurohet në një fazë të mëvonshme.</p>			

Masat fiskale dhe tatimore	Po me kusht		Në përputhje dhe zbatim të plotë të Ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave Ekonomike” i ndryshuar dhe legjislacioneve sektoriale të tjera në fuqi			
----------------------------	-------------	--	---	--	--	--

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I MJEDISIT

SOFJAN JAUPAJ

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)